




UNIVERSITETI I PRIZRENIT Prizreni Universiteti "UKSHIN HOTI" FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE FACULTY OF COMPUTER SCIENCE	
Pranuar me datë	29.12.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
429	451/22



**CODERS' HUB
KOSOVO**

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

FAKULTETIT TË SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

DHE

CODERS' HUB KOSOVO

Prizren, Dhjetor 2022

Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Prizren dhe Coders' Hub Kosovo

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike është një ndër njësitë mësimore shkencore të Universitetit të Prizrenit. Përmes programeve të veta studimore, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike ofron udhëzime dhe përgatit student për karrierë të bazuar në industri.

Gjatë studimeve studentët janë të mbuluar me të gjitha njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike. Kjo iu mundëson studentëve që të krijojnë projekte të mëdha dhe të vogla në çdo kompani brenda apo jashtë vendit.

Coders' Hub Kosovo është ndërmarrje e përbashkët e "CodeFactory Vienna" si shkolla më e suksesshme dhe me më së shumti eksperiencë në fushën e kodimit në Austri, si dhe e kompanisë së teknologjisë informative "Protecht". Që të dyja, kanë kombinuar vitet e tyre të eksperiencës në projektet e fushës së teknologjisë informative dhe të trajnimeve për të trajtuar një problem tashmë shumë të njohur: hendekun ndërmjet sistemit arsimor dhe industrisë në lidhje me gjetjen e zhvilluesve dhe profesionistëve të IT-së.

Neni 1

Me qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit në mes të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe Coders' Hub Kosovo, me pikësynim përkrahjen dhe zhvillimin e studentëve në fushën e teknologjisë informative, dy palët lidhin këtë memorandum duke pranuar bashkëpunimin reciprok në fushën e zhvillimit profesional, respektivisht për mbajtjen e trajnimeve dhe për fushat e tjera me interes të përbashkët.

Neni 2

Coders' Hub Kosovo, do të ofrojë trajnime intensive nga fusha e Teknologjisë Informative për studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Prizren, për aftësimin e tyre për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës.

Neni 3

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike në Prizren merr përsipër rolin e informimit dhe njoftimit të studentëve lidhur me trajnimet që do të organizohen nga Coders' Hub Kosovo.

Neni 4

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike në Prizren merr përsipër organizimin e sesioneve informuese me studentë të pranishëm, për promovimin e trajnimeve që organizohen nga Coders' Hub Kosovo.

Neni 5

Coders' Hub Kosovo do merr masat e nevojshme për të aftësuar studentët sipas planprogramit ndërkombëtar me standarde europiane, ku përfshihen trajnimet e ndryshme brenda fushës së Teknologjisë Informative si Full Stack Developer, Frontend Developer, Backend Developer, Amazon Cloud Practitioner and IT Fundamentals, Blockchain development, VR/AR development, Cyber Security, si dhe trajnime të tjera varësisht nga kërkesat e tregut.

Neni 6

Trajnimet intensive të organizuara nga Coders' Hub Kosovo, do të zhvillohen në klasat trajnuese të vetë organizatorit, më saktësisht në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP).
Në rast të rrethanave apo kushteve të paparashikuara që pamundësojnë mbajtjen e trajnimeve në klasat e Coders' Hub Kosovo, atëherë palët pajtohen që të përdoret përkohësisht infrastruktura e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike në Prizren.

Neni 7

Pjesëmarrja e studentëve në trajnimet e organizuara nga Coders' Hub Kosovo do të jetë pa pagesë.

Neni 8

Palët pajtohen që brenda vitit nga Coders' Hub të trajnohen afër 50 studentë, ndërsa për seleksionimin e tyre do të kujdeset Fakulteti i Shkencave Kompjuterike në Prizren.

Neni 9

Coders' Hub Kosovo do të njoftoj vazhdimisht Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Prizren, për planifikimin e organizimit të trajnimeve, si dhe informimin e saktë në mbarëvajtjen e procesit trajnues për studentët nga Fakulteti.

Neni 10

Coders' Hub Kosovo, përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, zotohet se studentët nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" të cilët shfaqin performancë të lartë gjatë trajnimeve, do të kenë mundësinë e punës praktike si dhe të punësimit të rregullt varësisht nga shkathtësitë individuale.

Neni 11

Të dy palët caktojnë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Neni 12

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe do të ketë afat të pakufizuar, përderisa njëra palë me shkrim nuk e njofton palën tjetër 6 muaj më parë, për ndryshimet eventuale.


Neni 13

Ky Memorandum i Bashkëpunimit nënshkruhet në dy kopje, për secilën palë nga një kopje.

Për:

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike


Prof. Asoc. Dr. Ercan Canhasi




Për:

Coders' Hub KOSOVO

Muhamer Nuridini



Datë: 29/12/2022, Prizren



MEMORANDUM OF AGREEMENT

BETWEEN

FACULTY OF COMPUTER SCIENCE

AND

CODERS' HUB KOSOVO

Prizren, December 2022

Memorandum of Agreement between Faculty of Computer Science in Prizren and Coders' Hub Kosovo

Faculty of Computer Science is one of the scientific teaching units of the University. Through its study programs, the Faculty of Computer Science provides guidance and prepares students for industry-based careers.

During the studies students are covered with all the necessary theoretical and practical knowledge. This enables students to create large and small projects in any company at home or abroad, as well as pursuing master studies.

Coders' Hub Kosovo Coders' Hub Kosovo is the joint venture of CodeFactory Vienna, Austria's most successful and oldest coding school and the IT company "Protecht". Both companies have combined years of expertise in IT projects and IT trainings between them and so they joined forces to tackle a well-known problem: the gap between the educational system and the industry in regards to finding developers and IT professionals.

Article 1

In order to raise the level of cooperation between the Faculty of Computer Science "Ukshin Hoti" and Coders' Hub Kosovo, with the aim of supporting and developing students in the field of information technology, the two parties agree for mutual cooperation in professional development, respectively organizing trainings and for other areas with common interest.

Article 2

Coders' Hub Kosovo, will offer intensive trainings for students who are part of the Faculty of Computer Science in Prizren.

Article 3

The Faculty of Computer Science, take the responsibility to inform students about the trainings that will be organized by Coders' Hub Kosovo.

Article 4

The Faculty of Computer Science take the responsibility to organize information sessions for CHK, to introduce and promote the trainings of Coders' Hub Kosovo in front of students of the Faculty.

Article 5

Coders' Hub Kosovo will take the necessary steps to train students of the Faculty, according to the international curriculum with European standards, which includes various trainings in the field of Information Technology such as Full Stack Developer, Frontend Developer, Backend Developer, Amazon Cloud Practitioner and IT Fundamentals, Blockchain development, VR/AR development, Cyber Security, as well as other training depending on market requirements.

Article 6

Trainings organized by Coders' Hub Kosovo, will be held on the trainings classes of the organizer, exactly at Innovation and Training Park (ITP).

In case of unforeseen circumstances or conditions that make it impossible to organize trainings in Coders' Hub Kosovo classes, then the parties agree to use temporarily the infrastructure of the Faculty of Computer Sciences in Prizren.

Article 7

The participation of students in trainings that are organized by Coders' Hub Kosovo, will be free of charge.

Article 8

The parties agree that nearly 50 students will be trained by Coders' Hub within the year, while the Faculty of Computer Science in Prizren will take care of their selection.

Article 9

Coders' Hub Kosovo will constantly notify the Faculty of Computer Science in Prizren, for the plan of trainings, as well as accurate information on the progress of trainings process for students who are part of the Faculty.

Article 10

Coders' Hub Kosovo, through this Memorandum of Cooperation, declare that students from the University of Prizren "Ukshin Hoti" who manifest high performance during trainings, will have the possibility of internship work, also as regular work depending on individual skills.

Article 11

The parties appoint two representatives for the follow-up and realization of the cooperation defined by this memorandum.

Article 12

This Memorandum of Cooperation entered into force on the day of its signing and will have an unlimited term, as long as one party does not notify the other party in writing 6 months before, about possible changes.

Article 13

This Cooperation Memorandum will be signed in two copies, one copy for each party.

For:

Faculty of Computer Science

Prof. Asoc. Dr. Ercan Canhasi

Ercan Canhasi



Date: 29/12/2022, Prizren

For:

Coders' Hub KOSOVO

Muhamer Nuridini

